



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e X-të (dhjetë) -urgjente, mandati VIII-të, e mbajtur më 01 qershor 2026.

Mbledhja filloi në orën 13:25 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Të pranishëm në mbledhje ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Valdet Kamerolli; Flandra Kadriu; Luljeta Muçolli-Azemi; Haki Rudari; Abedin Zeka; Qëndresë Hajrizi; kurse munguan: Adelinë Stublla; Fatri Zhitija; Florent Hasani; Arbrim Konushevci; Vlora Jashanica; Avni Islami; Ardi Hasani,

Nga LDK: Enis Shabani; Enis Dervisholli; Besim Latifi; Valdet Restelica; Blerta Azemi-Berisha; Ekrem Rrahmani; Gresa Qosa-Maqastena; Arben Xhemajli; Isak Ejupi, kurse munguan: Alisa Jetullahu; Valon Demolli; Ermal Osmani; Arnisa Sylejmani

Nga PDK: Isak Shabani-Kryesues i Kuvendit; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu, kurse mungoi, Rinesa Goxhufi,

Nga GUXO: Demokrat Hodolli.

Nga Unioni i Blakçorve: Gentrif Arifi.

Nga AAK: Baki Feta,

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Fahri Restelica Nënkyetar i Komunës; U.D. drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Ditjona Statovci-Drejtoria e Administratës DA; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Valbona Ibishi Azemi-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shuajb Blakçori-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Behram Latifi-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi), dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

- **Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës, ish objektin e Gjendjes Civile në fshatin Orllan**

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje në këtë mbledhje, konstatoi kuorumin ku sipas listës së nënshkrimeve dhe numërimit, 23 anëtar/e të Kuvendit janë prezent në sallë dhe se Kuvendi ka kuorum të mjaftueshëm për punë dhe vendimmarrje.

Kjo seancë është thirrur në përputhje me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës dhe në pajtim me Rregulloren e punës. Duke qenë se ftesa dhe materialet për këtë mbledhje ju janë shpërndarë me kohë, e shpall të hapur mbledhjen e dhjetë, urgjente, të mandatit të VIII-të të Kuvendit Komunal të Podujevës.

Të nderuar asamblastë, para jush gjendet propozim rendi i ditës për këtë mbledhje, Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës të ish-objektit të Gjendjes Civile në fshatin Orllan. Siç e keni parë nga materialet kërkesa ka ardhur nga Kryetari i Komunës, prandaj në emër të Kryetarit sigurisht që ndokush nga drejtorët ka marrë përsipër ta prezantojë arsyeshmërinë, urdhëroni fjala për ju.

z.Bahri Selimi, U.D. i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, theksoi, shumë i nderuari Kryesues, i nderuari Nënkyetar i Komunës, kolegë drejtorë të Drejtorive, shumë të respektuar asamblastë të Kuvendit Komunal. Faleminderit që sot keni gjetur kohë dhe jeni këtu me ne në këtë seancë urgjente që ndoshta pak e shkurtër për nga njoftimi, mirëpo vetë fjala “urgjente” nënkupton që është dashur të bëhet në këtë formë.

Sot jemi këtu për të shqyrtuar propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht Policisë së Kosovës, ish-objektin e Gjendjes Civile në fshatin Orllan, çështje kjo për të cilën paraprakisht kemi biseduar edhe me Grupet politike në mbledhjen e fundit të Kuvendit dhe parimisht jemi dakorduar kështu që të thirret një seancë urgjente në mënyrë që të diskutohet kjo pikë e rendit të ditës.

Jam në dijeni ashtu siç e ceku edhe Kryesuesi që materialin e keni pranuar të gjithë dhe aty gjendet i gjithë dokumentacioni që e arsyeton këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo diçka çka do t'ju thoja është se ju fillimisht e keni parë se është një kërkesë e cila ka ardhur nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila i është drejtuar Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të atij objekti i cili do ta rregullonte dukshëm infrastrukturën e Policisë së Kosovës.

Besoj që secili prej nesh e dim që nënstacioni në Orllan ka funksionuar në gjendje që mund të themi të jashtëzakonshme për shkak të objektit të stërvjetëruar dhe rrezikut që ekziston aty si dhe pamundësia për ta rritë numrin e policëve aty, andaj për të funksionuar tamam si nënstacion policor ka qenë e domosdoshme që të vëhet në rend të ditës apo që të bëhet kjo kërkesë në mënyrë që policia ta kenë një ambient më të përshtatshëm në mënyrë që të funksionojnë edhe si nënstacion por edhe të rritet numri i tyre.

Tashmë jam i njoftuar edhe nga Policia që numri i policëve që do të operojnë në atë zonë të Orllanit është 10, por që në hapësirat aktuale ku kanë funksionuar nuk ka vend të mjaftueshëm për funksionim normal dhe ka qëndruar vetëm një polic sa për të mos mbetur nënstacioni ashtu bosh.

Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Policia e Kosovës, e vlerëson si pikë strategjike këtë nënstacion policor dhe për shkak të vlerësimit si pikë strategjike është dashur që ne të veprojmë dhe t'ju japin në shfrytëzim një objekt i cili për momentin është jo funksional, mirëpo thënë të drejtën ka qenë jo funksional gjithëherë sepse ka funksionuar me humbje dhe nuk ka pasë interesim të madh të qytetarëve që të marrin dokumentacion në atë pjesë për shkak të numrit të banorëve por edhe për shkak të dokumentacionit i cili si të nxjerrët në Orllan si të vihet në Podujevë përsëri punët janë kryer në Podujevë, andaj ne tani kemi rënë në dakord që ta vëm para juve këtë propozim vendim dhe ta marrim edhe miratimin e juaj në mënyrë që Policia të fillojë sa më shpejt funksionimin e këtij nënstacioni dhe që qytetarët e asaj pjese të cilët kanë kërkuar shumë

herë rritjen e numrit të Policëve e që sigurisht kjo për shkak të sigurisë për çka sigurisht që ka këtu edhe ekspert, policë dhe ish komandantë të stacionit policor të cilët besoj që e kuptojnë dhe e vlerësojnë shumë qartë se sa e rëndësishme është ajo pikë për shkak se është edhe afër brezit kufitar dhe që është një pambulueshmëri shumë e madhe me policë po që se ajo pikë është pasive që në fakt mund të themi se ashtu qysh ka qenë deri më tani duke operuar vetëm me 1 polic i cili pothuajse ka qëndruar aty më shumë vetëm sa për sigurimin e atij objekti se sa që të merret me problemet e qytetarëve.

Prandaj unë edhe njëherë kërkoj nga ju që të miratoni vendimin për dhënien në shfrytëzim të asaj hapësire e cila është mëse e nevojshme për Policinë e Kosovës.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pasi jemi në dijeni se është vetëm një pikë e rendit të ditës dhe nuk ka mundësi plotësim ndryshim të rendit të ditës, por që tani kërkoj nga ju kush dëshironi të merrni fjalën rreth kësaj mbledhje.

z.Haki Rudari, theksoi, të dashur qytetarë, në seancën e sotme kemi vetëm një pikë të rendit të ditës që është Propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër Ministrisë së Punëve të Brendshme ish-objektin e Gjendjes Civile në Orllan.

Duke u nisur nga një fakti i pamohueshëm që Orllani me fshatra përreth është zonë kufitare, konsiderojmë se kjo çështje është shumë emergjente dhe me rëndësi të veçantë që atje të fillojnë punimet ose që ai projekt konsiderojmë se ndikon shumë në sigurinë e qytetarëve edhe ashtu në një kohë kur është i boshatisur, por që në anën tjetër veç ka filluar kthimi i shumë qytetarëve në atë pjesë, prandaj në emër të Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, e mbështesim këtë projekt dhe konsiderojmë dhe kërkojmë në bazë të kompetencave që ka ky Kuvend, nga Ministria që të filloj sa më shpejtë realizimi i këtij projekti në interes të qytetarëve.

z.Isak Ejupi, theksoi, që në fillim dua të sqaroj se ne Grupi i LDK-së do ta përkrahim këtë iniciativë, respektivisht do ta votojmë për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone, por megjithatë kemi vërejtje për mënyrën se si është organizuar kjo mbledhje, sepse në bazë të kësaj që unë kam analizuar nuk ka pasur asnjë nevojë emergjente që kjo çështje të trajtohet me kaq urgjencë por që kjo është dashtë të përgatitet për seancën e radhës të rregullt ose të punohet në mënyra tjera, pra megjithatë mënyra se si është thirr kjo mbledhje nuk përkon me realitetin, pra nuk ka asnjë fatkeqësi natyrore apo ndonjë arsye tjetër që do ta bënte urgjente këtë çështje sepse siç e dim të gjithë, Policia është e pranishme në atë zone, dhe për ko incidencë në vitin 2014 kur unë personalisht kam qenë komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, kur është ri funksionalizuar nënstationi policor në Orllan dhe atëherë e kam vlerësuar se është e nevojshme që të ketë prezencë policore në atë pjesë sepse ai nënstation mbulon saktësisht 19 fshatra të asaj zone dhe konfiguracioni i terrenit të Komunës së Podujevës e kërkon një nënstation në atë zonë për arsye se ka shumë fshatra dhe ka shumë nevojë për qytetarët e asaj ane që të ndihen më të sigurt se sa që kanë qenë, prandaj edhe kemi vendosur ta rihapim në atë pjesë nënstationin policor.

Objekti aktual i atij nënstationi ka qenë dhe është në gjendje të mjerueshme prej momentit kur e kemi marrë atë nënstation në shfrytëzim ose prej kur e kemi rihapë atë, prandaj nëse prej atëherë e deri më sot është në atë gjendje përse të mos jetë edhe 2-3 javë apo 1 muaj për të organizuar një seancë pak më kadale dhe pak më mirë, e jo me urgjencë kaq të madhe, andaj mendoj se kjo është çështje e cila nuk është dashtë të trajtohet në këtë formë dhe me kaq nguti dhe pa asnjë analizë të saktë të aspekteve të sigurisë në zonën ku do të dislokohej Policia.

Çështja tjetër është se ka të bëjë me një objekt të Gjendjes Civile që është i destinuar për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe nuk i plotëson kushtet për të qenë nënstation policor dhe si i tillë ai kërkon investim për t'u përshtatur me nevojat e Policisë së Kosovës, kurse në aspektin tjetër është se po mbyllet një zyrë që ka ofruar shërbime për qytetarët e asaj zone dhe që nga viti 2005 kjo

është zyra e pare e hapur në terren në nivel Komune dhe që shërben për një zone kufitare, prandaj rëndësia e saj për banorët e asaj ane nuk duhet të neglizhohet, andaj propozoj që objekti aktual që e kanë në shfrytëzim Policia e Kosovës t'i kthehet Komunës së Podujevës dhe të rinovohet për t'u rihapë Zyra e Gjendjes Civile pasi që ajo zonë ka nevojë permanente për shërbimet që ofron ajo zyrë e Gjendjes Civile.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, duke qenë se jam nga ai regjion, nuk kam çka të shtoj shumë por do të doja t'i theksoj disa arsye pse kjo pikë duhet të miratohet. Për arsyeshmërinë e urgjencës besoj që e ka dhënë Ministria e Punëve të Brendshme, kështu që nuk do të ndalem shumë, mirëpo ne e dimë që në fshatrat kufitare, do të thotë Orllani ka qenë një komunë që kanë gravituar 11 fshatra e që pothuajse të gjitha janë në zonë kufitare. Tani kemi boshatisje të madhe të atyre fshatrave, madje dy fshatra nuk kanë asnjë banorë, Bllatë, Muhazob, kurse në Rakinicë është një familje, prandaj unë jam në kontakt të përhershëm meqë jam duke jetuar aty dhe në disa raste qytetarët kanë raportuar se kanë vërejtur edhe pjesëtar të Policisë edhe të Ushtrisë serbe në kufi, madje dyshohet se ka pasë edhe lëvizje në ajr në zonat kufitare me dron të dyshimtë, andaj rritja e numrit të policëve do të ndikojë në rritjen e sigurisë e në veçanti të banorëve të atij regjioni.

Ne e dimë se kufirin nuk mund ta ruajmë kur nuk është gjendje lufte Policia dhe Ushtria, por e ruajnë banorët që jetojnë atje, mirëpo kur banorët e dinë që ka një nënstacion do të ndihen shumë më të sigurt e që edhe kjo është njëra prej arsyeve që të rritet numri i policëve sepse ashtu siç ka qenë deri tani me 1 policë i cili ka kujdestaruar dhe 1 patrullë, nuk ka qenë i mjaftueshëm.

Sa i përket kushteve ku është e vendosur Policia atje, unë e kam vizituar të shtunën dhe me të vërtetë kushtet kanë qenë mizore, pastaj e kam vizituar edhe objektin i cili është tani në propozim për t'iu dhënë në shfrytëzim dhe i cili plotëson kushte më mirë se ai që ka qenë deri tani, jo ndoshta të gjitha, por i plotëson.

Unë e përkrahë kolegun parafolës z.Isak Ejupi i cili e potencoj se do duhej të mendohet dhe do të ishte mirë të studiohet edhe mundësia që të kenë edhe shërbim të Gjendjes Civile qytetarët e asaj ane, por në atë objekt ndoshta për momentin nuk munden sepse është shumë i rrezikshëm për të qëndruar aty ngase kush ka gravituar andej ka mund ta vërej se ka filluar edhe pullazi është duke u shkatërruar për të mos thënë duke u shembur tërësisht.

Dua të ngrisë edhe një gjë, gjatë sezonit të verës mbi 250 mijë qytetarë frekuentojnë zonën e Orllanit dhe po e marrë një shembull që e dëgjova edhe dje në fshat por që sot e pash edhe në portale që Policia e Kosovës ka shpëtuar një jetë të një qytetari te Liqeni i Batllavës, pra do të thotë se nëse qëndrojnë aty policët dhe ka patrullë, mund t'ju del në ndihmë edhe në raste të aksidenteve apo fatkeqësive të ndryshme, prandaj ju lus si asambleistë ta përkrahni këtë propozim vendim.

z.Enis Dervisholli, theksoi, i nderuar Kryesues edhe ne jemi për ta përkrahë këtë iniciativë, por po e përdorni për fushatë, përndryshe ne nëse paraqitet nevoja edhe shtëpitë tona i lëshojmë për Policinë e Kosovës, nuk jemi ata persona që i gjuajmë Policinë me gurë, andaj mos hyni në këto tema sepse këtë jeni duke e bërë në mënyrë politike për fushatë, përndryshe është dashtë ta merrni këtu në Kuvend edhe Ministrin zotëri Sveçla. Pra ju lus për këtë sepse është dashtë ta kryeni këtë punë edhe më parë, madje kemi mundur ta kryejmë edhe të enjten e kaluar kur ishte seanca e Kuvendit por kemi mundur edhe në seancën e radhës sepse nuk është urgjente.

Ti nëse nuk ke shkuar në Orllan dhe e keni villën atje e që ke mundur të shkosh edhe para 2 apo 3 muajve e të vizitoni stacionin e policisë atje, por e gjetët tani bash në kohë të fushatës që ta vizitoni atë stacion, prandaj po e them që mos i shfrytëzoni edhe Policinë e Kosovës për fushatë, madje do të doja të ishte këtu prezent edhe Kryetari sepse nuk është mirë të shfrytëzohen Policia në fushata zgjedhore sepse nuk është gjë e mirë. Normal e kuptoj se nuk i kanë kushtet e mira, madje jo vetëm në stacione por në shumë vende jeni duke i'u hyrë në hak.

z.Bahri Selimi, U.D. i DSHPMSh, theksoi, shqetësimeve dhe pyetjeve tuaja po mundohem t'ju jap arsyetimet dhe përgjigje ashtu siç ne i kemi marrë dhe në bazë të komunikimit të vazhdueshëm që kemi pasur me Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Sa i përket asaj përse kjo mbledhje është thirr me urgjencë, ju them se kjo ka qenë kërkesë urgjente e Ministrisë. Ata na kanë njoftuar se kanë qenë për vizitë në ditën e Bajramit, dhe sa kam informacion të saktë, gjatë asaj dite dikush nga banorët e ka ngritur këtë shqetësim. Atje ka qenë vetë ministri së bashku me zyrtarë të Ministrisë dhe e kanë vizituar gjendjen e stacionit policor aktual që tashmë është i vjetër, por njëkohësisht i kanë parë edhe hapësirat e zyrës së gjendjes civile atje. Në bazë të vlerësimeve të ekspertëve që kanë qenë prezentë aty, meqë tani doli edhe pyetja tjetër sa i përket plotësimit të kushteve të atij objekti që është propozuar të jepet në shfrytëzim, pra në bazë të ekspertëve të cilët kanë qenë atje dhe e kanë vizituar, është konstatuar se zyra i plotëson kushtet, sigurisht, ndoshta jo në masën 100%, por në një nivel jashtëzakonisht të mirë i plotëson kushtet, ata i kanë parë të gjitha dhomat dhe e kanë studiuar duke parë nga afër dhe duke dalë me një Qëndrim se është në rregull.

Sa i përket Zyrës së Gjendjes Civile që u ngrit si shqetësimi që u tha se nuk është në rregull dhe nuk është mirë që Orllani të mbetet pa shërbimin e Gjendje Civile, dua t'ju njoftoj që ndoshta ka 2 ose 3 vite kur Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) ka rekomanduar mbylljen e të gjitha zyrave të gjendjes civile në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe këtë, mirëpo ne nuk kemi ndërmarrë hapa të menjëhershëm, sepse kemi dashur që ky proces të zhvillohet gradualisht deri në momentin kur të plotësohen kushtet dhe mundësitë, në mënyrë që qytetarët të mos mbeten pa shërbime atje. Sa për informacion, unë e kam edhe një statistikë këtu lidhur me dokumentet e lëshuara në Orllan, në Zyrën e Gjendjes Civile, pra këtu është një raport nga data 1 janar 2026 deri më sot ku jemi në 1 qershor 2026 që i bie fiks 5 muaj, pra për pesë muaj të plotë, në Zyrën e Gjendjes Civile në Orllan janë lëshuar në total 81 dokumente, ndërsa në fshatin Batllavë, që është afër asaj zone, gjatë së njëjtës periudhë janë lëshuar afër 400 dokumente. Tani i gjithë dokumentacioni që ka qenë në Orllan është bartur në Batllavë dhe qytetarët e asaj pjese vazhdojnë të kenë shërbime të gjendjes civile, vetëm se distanca do të jetë pak më e largët sepse Zyra e Gjendjes Civile në Batllavë tashmë është funksionale dhe ideja ka qenë që të mos mbyllet kjo Zyrë në Batllavë për shkak të territorit më të gjerë dhe numrit më të madh të fshatrave që frekuentojnë atje, mirëpo kjo është statistika që del nga Zyra e Gjendjes Civile. Nuk po foli për të hyra dhe se sa është ekonomik të mbahet ajo Zyrë, por vetëm si statistikë e paraqita se për 5 muaj janë lëshuar vetëm 81 dokumente në Orllan.

Besoj u mundova të jap të gjitha përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme, por nëse ka edhe të tjera jam i gatshëm të marr fjalën sërish.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e përmendi drejtori parafolës që edhe ne ishim në dijeni gjatë seancës të enjten e kaluar se kjo çështje ishte me urgjencë. Nuk e di pse, për shembull, atë ditë nuk u thirr seanca menjëherë pas seancës tjetër, ose të paktën atë ditë të thirrej mbledhja për të premtën, por të thirret sot në orën 11:00 për në orën 13:00. Mendoj që tani po dalin keq edhe ata që nuk kanë mundur të vijnë në këtë seancë sepse ne e dimë që më shumë se gjysma këtu punojnë edhe në sektorin privat. Dikush është dashur të vijë prej Fushë Kosovës, dikush prej Prishtinës, pra nuk e kuptoj pse, pasi i kishit dokumentet në dorë të enjten nuk e thirrët mbledhjen për pasdite, mirëpo edhe sot, nëse e keni thirrur sot mbledhjen, çka do të bëhej të mbahej kjo seancë në orën 08:00 të mbrëmjes. Këtu ose po i bie që ka përtuar të vie Kryesuesi, ose drejtorët kanë përtuar të kthehen edhe njëherë. Pra kemi pasë mundësi që në mbrëmje ta mbajmë këtë seancë, dhe të mos thirret kështu kaq për ngutë dhe të mos u'a mundësojmë të tjerëve të vijnë në seancë.

Pastaj këtu tani po del që opozita është më serioze sepse do të thotë nëse ne dalim, këtu nuk ka kuorum për t'u mbajtur seanca, ngase prej pozitës nuk kanë ardhur as gjysma e asamblistëve, jo që po i fajësoj sepse ndoshta koha ka qenë shumë e shkurtër.

z.Isak Ejupi, theksoi, dua të jap vetëm edhe një sqarim shtesë, unë po e përsëris edhe njëherë se në vitin 2014, kur unë e kam vlerësuar që ka nevojë të ketë prezencë policore në atë zone dhe kam bërë shkresa dhe memorandume për funksionalizimin e saj, dhe me vështirësi e kemi realizuar, megjithatë, Policia operon në atë objekt prej vitit 2014, do të thotë nuk ka asnjë argument që sot mund të ofrohet që ka kaq shumë emergjencë, sepse nuk kemi pasur situatë emergjente dhe nuk kemi pasur ndonjë ndërhyrje. Unë e di edhe arsyen, sepse kam informacione të mjaftueshme për operimin e policisë së Serbisë në atë zonë, ose edhe të Xhandarmërisë. Do të thotë, qëllimi i lëvizjes së tyre bëhet kryesisht për parandalimin e dëmtuesve të pyjeve andej, pra nuk ka ndonjë cenim të integritetit territorial të Kosovës, nuk bëhet me atë qëllim, edhe pse vetë prezencja e tyre atje është absolutisht shqetësuese, mirëpo nuk është që vetëm sot ata po operojnë në brendinë e Kosovës, por është dukshëm më e hershme, unë i kam këto informata.

Megjithatë po them se jam absolutisht dakord dhe Grupi ynë është dakord që ne ta forcojmë sigurinë atje dhe të operojmë me Policë e që drejtori parafolës e tha me 10 Policë, mirëpo për funksionalizimin e nënstacionit atje duhen 17 Policë, duke përfshirë edhe një epror që duhet të jetë aty, si nënstacion. Prandaj e themi se absolutisht është e nevojshme, por mënyra se si është thirr dhe si është trajtuar kjo temë, kam përshtypjen që është paksa e gabuar.

z.Bahri Selimi, U.D. i DSHPMSh, theksoi falënderoj shumë parafolësin asambleistin zotëri Ejupi dhe edhe unë pajtohem plotësisht që edhe ju po e vlerësoni se është e rëndësishme. Edhe ju në cilësinë e ekspertit apo të ish komandantit të Stacionit Policor e dini shumë mirë dhe po e potenconi vetë që operimi në atë pjesë është shumë i nevojshëm, madje e çekët 17 Policë, ndërsa mua sipas konsultimeve që janë bërë edhe me Stacionin Policor por edhe me MPB, më është thënë se janë 10 Policë aty, plus një epror, në këtë rast një rreshter, që i bie gjithsej 11 persona.

Sa i përket objektit nuk dua të kthehem sërish të foli për atë sepse për besë 1 Policë është keq të qëndroj aty e lëre më 11 sepse e kam parë gjendjen e atij objekti prandaj ndoshta kjo është edhe gjendja urgjente sepse gjysma e kulmit është i rrënuar dhe objekti është në gjendje mjaft të mjerueshme dhe mjaft të rëndë, gjithsesi ju faleminderit edhe njëherë për të gjitha sqarimet.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, vetëm dua t'ju rikujtoj se të enjten unë kam provuar me udhëheqësit e Grupeve të këshilltarëve të kësaj asambleje, por nuk kemi mundur të arrijmë marrëveshje. Kështu që mbledhja u shty dhe nuk është arsyeja ime pse unë nuk e kam mbajtur të premtën, por sot. Mbi të gjitha, sot ka ardh propozimi, e kam parë arsyeshmërinë, por sigurisht që nuk kam hyrë në ato proceset e sigurisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mirëpo mbi të gjitha, një diçka që më ka bindur edhe më shumë ishte kur lexova sot në mëngjes dhe dëgjova nga qytetarët se dje është shpëtuar një jetë nga Policë të cilët kanë qenë atje në detyrë, kështu që po mendoj se çdo gjë që bëhet është shumë e dobishme, sidomos kur përfitojnë qytetarët, dhe po ashtu po ju përshëndes të gjithëve që shprehët gatishmërinë që ta përkrahni këtë pikë të rendit të ditës.

Atëherë, meqë deklaratimet rreth kësaj mbledhje dhe rendit të ditës u paraqiten, unë po e hedh në votim kush është për që kjo pikë e rendit të ditës të diskutohet në këtë mbledhje, që është; Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës, ish-objektin e Gjendjes Civile në fshatin Orllan.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 23 vota Për, nga anëtarët e pranishëm që ishin prezent në këtë mbledhje, miratohet propozimi që të vazhdohet me këtë mbledhje, përkatësisht miratohet rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, respektivisht me pikën e rendit të ditës:

➤ **Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës, ish objektin e Gjendjes Civile në fshatin Orllan**

Kryesues i Kuvendit, vazhdoi, do të thotë 23 të pranishëm votuan që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet dhe të vazhdoi kjo mbledhje, andaj unë e hap diskutimin edhe pse shumica thuajse përfunduan diskutimet paraprkisht në hyrje, megjithatë është e drejtë e secilit që dëshiron të marrë fjalën për diskutim. Atëherë, urdhëroni fjala për ju.

z.Enis Dervisholli, theksoi, i nderuar Kryesues, neve për fat të mirë nuk është duke na menaxhuar askush nga jashtë që ta lëshojmë seancën, e them këtë sepse të enjten në seancën e kaluar i keni maltretuar edhe asambleistët tjerë në disa raste duke i'u thënë hyni, dilni, mos bëni kuorum e gjëra të tilla, kurse neve për fat të mirë nuk na menaxhon askush nga jashtë, por kemi vendos sot të vijmë në këtë mbledhje edhe pse thirrja dhe materiali na ka ardh me vonesë.

Edhe njëherë e themi se ne mbështesim këtë mbledhje dhe këtë propozim vendim, madje natën e ditën dhe kurdo që ka nevojë për Policinë e Kosovës ne jemi të gatshëm t'ju përgjigjem.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes dhe miratuar paraprkisht.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 23 vota Për, nga anëtarët e pranishëm që ishin prezent në këtë mbledhje, miratohet propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës, ish objektin e gjendjes civile në fshatin Orllan, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të mbyllur / përfunduar këtë mbledhje, duke i falënderuar të pranishmit për kontributin dhe korrektësinë e treguar në këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 13:55

**Procesverbalin e mbajti dhe hartoi;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0031639/26
Podujevë,
01 qershor 2026**

**Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani**